

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Gani Zabeli, kryetar i kolegjit, Afrim Shala dhe Ferit Osmani, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarës A.G., nga Shtimja, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1445-7/16, të datës 30 prill 2018 dhe ankesës së palës së dëmtuar A.E., të datës 7 maj 2018, të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1078/2016, të datës 18 prill 2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 11 korrik 2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.1078/2016 i datës 18 prill 2018, VËRTETOHET.

II. HUDHET si e palejuar ankesa e palës së dëmtuar A.E..

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktgjykimin e lartcekur, të akuzuarën A.G., e ka liruar nga akuza, meqë nuk është provuar se e njëjta e ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1. të KPRK.

Shpenzimet procedurale bien në barrën e mjeteve buxhetore të gjykatës së shkallës së parë.

E dëmtuara A.E., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor kanë paraqitur ankesë:

- Prokuroria Themelore në Ferizaj, për shkak të vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë, ashtu që ndaj të akuzuarës të merr aktgjykim dënues, sipas së cilit aktgjykim të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta dënojë sipas ligjit, si dhe

- E dëmtuara A.E., për shkak të shkeljeve eseciale të dispozitave procedurale të KPP dhe për shkak të vërtetimit të gabueshem dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar me këtë ankesë dhe të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta dënoj sipas ligjit.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.536/2018, të datës 18 maj 2018, ka propozuar që të aprovet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, ndërsa të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar, ashtu që të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta dënojë sipas ligjit, ndërsa ankesa e të dëmtuarës të hudhet si e palejuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- ankesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj është e pabazuar, ndërsa ankesa e të dëmtuarës A.E. është e palejuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes së ligjit penal, megjithatë Gjykata e Apelit e Kosovës, konform së nenit 394 të KPP, të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë drejtim dhe gjeti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përmban shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarës.

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj theksohet se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 386 paragrafi 2 dhe 3 për shkak se ka vërtetuar gabimisht gjendjen faktike, ngase gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejtë faktin se lëndimet e lehta trupore e dëmtuara i ka marrë si pasojë se e akuzuara e ka kapur për krahu të majtë dhe e ka shtrënguar fortë ku me atë rast e ka shtyrë edhe për muri. Gjykata fillimisht vërteton drejtë gjendjen faktike kur thotë se: nuk është kontestuese se më datë 27 prill 2016 të njëjtat kanë patur një takim dhe një mosmarrëveshje, nuk është kontestuese se e dëmtuara i kishte thënë se do ta paraqesë te shefi i personelit të akuzuarën dhe e akuzuara është duke ja shkruar një vërejtje me shkrim të dëmtuarës dhe se nuk është kontestuese se e dëmtuara ka pësuar lëndim të lehtë trupor e cila dëshmohet me ekspertizën mjeko ligjore të datës 29 janar 2016. Por, gjykata gabimisht vlerësoj faktin se nuk është e mundur të vërtetohet se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, pasi që ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet fajësia e të akuzuarës. E akuzuara pasi që kishte konflikte me të dëmtuarën me qëllim që ta largoj nga puna pa bazë ka bërë kritika të vazhdueshme në prani të të tjerëve ndaj të dëmtuarës deri në atë masë sa

edhe i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor me pasoja të përkohshme për shëndetin. Fakti se lëndimi është shkaktuar po atë ditë vërtetohet nga raporti mjekësor i datës 27 prill 2016 dhe nga ekspertiza e mjekut mjeko ligjor. Fakti se e akuzuara ju ka drejtuar të dëmtuarës me fjalët “duhet të sillesh më mirë se nuk je në livadhet e Vojnovcit” vërtetohet nga deklaratata e të dëmtuarës dhe nga dëshmia e dëshmitarit G.B.. Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Prokuroria Themelore në Ferizaj i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ankesa të aprovohet ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet, ku me atë rast e akuzuara të shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet e lartcekura të Prokurorisë Themelore në Ferizaj janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike. Një gjendje të tillë faktike, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar pas administrimit të një mori provave gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor. Në këtë drejtim gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha provave që janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, vlerësimi i të cilave është bërë një nga një dhe duke i ndërlidhur në mënyrë reciproke njëra me tjetrën. Provat mbi bazën e të cilave është vërtetuar gjendja faktike nga ana e gjykatës së shkallës së parë janë: deklaratata e të akuzuarës gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklaratat të e të dëmtuarës A.E., deklarimi i dëshmitarit G.B., raporti mjekësor të Poliklinikës “Aorta Plus”, ekspertiza mjeko-ligjore, raportet informuese policore, vendimi i lëshuar nga komisioni disiplinor, akt emërimi, vendimi i komisionit për shqyrtimin e kontesteve dhe ankesave dhe vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Nga të gjitha këto prova të cilat janë administruar dhe vlerësuar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, gjykata e shkallës së parë drejtë kishte vepruar kur të akuzuarën A.G. e kishte liruar nga akuza, ngase nuk është provuar se e njëjta e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Edhe Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se e akuzuara A.G. ditën kritike, përkatësisht me datën 26 prill 2016, në orën 14:00 në zyrat e Komunës së Shtimes ta ketë sulmuar të dëmtuarën A.E., duke e kapur për krahun e majtë në pjesën e sipërme, duke e shtrënguar fort, ku edhe dëmtuara rrëzohet në tokë. Kjo për faktin se dëshmia e të dëmtuarës A.E. është vlerësuar si subjektive dhe si hakmarrje ndaj të akuzuarës për shkak të raporteve jo të mira në mes të saj dhe të akuzuarës A.G., e cila në atë kohë ishte drejtoreshë, ndërsa e dëmtuara ishte zyrtare komunale. Përveç kësaj, pretendimet e paraqitura në ankesë se e dëmtuara A.E. është rrëzuar përtokë nuk ka gjetur mbështetje as në deklaratën e vet të dëmtuarës e cila gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor nuk kishte deklaruar se është rrëzuar në tokë, gjë që konstatohet edhe në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar faqja 5 pasuesi i fundit ku thuhet se “...nga kjo shtyrje veç sa nuk jam rrëzuar në tokë”. Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe se nga provat të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar. Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se jo çdo dyshim është i mjaftueshëm për t’u shpallur fajtor i akuzuari, por duhet që fajësia e të akuzuarit të vërtetohet përtej dyshimit të bazuar

mirë, duke ju referuar provave të besueshme, kredibile dhe të marra në mënyrë të ligjshme. Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto që u cekën më lartë, Gjykata e Apelit e Kosovës vendosi që ta refuzojë si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Sa i përket ankesës së të dëmtuarës A.E., Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se e njëjta është e palejuar. Kjo për faktin se në nenin 381 paragrafi 3 të KPP është parashikuar se “I dëmtuari mund të ushtrojë ankesë ndaj aktgjykimit vetëm për shkak të vendimit të gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale”. Duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, Gjykata e Apelit e Kosovës konstaton se ankesa e të dëmtuarës A.E., e paraqitur ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është e palejuar, për shkak se në këtë rast ankesa është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, baza këto ankimore për të cilat pala e dëmtuar nuk ka të drejtën e paraqitjes së ankesës ndaj aktgjykimit.

Duke u bazuar në këto që u tha më lartë e në bazë të neneve 400 dhe 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

Departamenti i Përgjithshëm

PA1.nr.529/18, Më 11 korrik 2018

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:  
Afrim Shala

Kryetari i kolegjit,  
Gani Zabeli

Ferit Osmani